




Bashkia DURRËS



PLANI I PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR *BASHKIA DURRËS 2024-2026*



Përmbajtja

Hyrje	3
1. Arritjet përgjatë zbatimit të planit të përmirësimit 2021-2023 si dhe kontributi i Bashkisë Durrës.....	4
Taksa e përkohshme e arsimit në Bashkinë Durrës.	5
Qëllimi	5
Shtrirja.....	6
Vizioni.....	6
Misioni	6
Objektivat.....	6
Përgjegjësitë.....	6
2. Të dhëna për arsimin parashkollor në Bashkinë Durrës	7
2.1 Qëllimi.....	7
2.2 Të dhëna të përgjithshme	7
2.3 Qëllimi i Politikës së Programit.....	11
2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor	18
2.4.1 Bordi i Kopshtit.....	18
2.4.2 Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit.....	20
3. Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	23
3.1 Qëllimi.....	23
3.2 Objektiva të përgjithshëm	23
3.3 Burimet Njerëzore.....	23
3.3.1 Rekrutimi i stafit	23
3.4 Menaxhimi i godinave	25
3.4.1 Rikonstruksioni i kopshteve.....	25
3.5 Ushqimi.....	34
3.5.1 Planifikimi i shërbimit të ushqimit në kopshte	34
4. Buxheti.....	37

Hyrje

Në Shqipëri në vazhden e ndryshimeve politike, në vitin 2015, u përfshinë edhe ndryshimet që lidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë me mënyrën e organizimit të Bashkive në Republikën e Shqipërisë. Si rezultat u krijuan 61 Bashki, të cilat përballen me ndryshime të shumta organizative dhe administrative. Në këtë kuadër për shkak të decentralizimit Bashkive ju shtohen disa detyra, si dhe nevoja për t'ju përgjigjur më mirë nevojave për zhvillim dhe mirëqenie sociale dhe ekonomike.

Ndërkohë në bazë të ligjit 69/2018 të ndryshuar për Arsimin, bashkisë i kalon nën juridiksionin e saj çdo qështje që lidhet ngushtë me mbarëvajtjen e arsimit parashkollor. Në këtë kuadër, Bashkia Durrës, si një ndër 6 bashkitë pilot që u asistuan gjatë fazës së parë të projektit Bashki të Forta, hartoi një plan përmirësimi të arsimit parashkollor për tre vite, 2020-2023. Në këtë plan përmirësimi u realizuan një sërë projektesh për të cilat bashkia mori angazhim. Nisur nga fakti së një vit më pas, në vitin 2021 Bashkia Durrës, u angazhua për të vendosur një taksë të përkohshme në arsimin parashkollor e cila kaloi në të gjitha etapat ligjore në hartimin dhe miratimin e saj, i lind nevoja të hartojë planin e përmirësimit të arsimit për vitet 2024-2026, për implementimin e saj sipas projekteve specifike të cilat do të jenë pjesë e planit të përmirësimit parashkollor 2024-2026, i cili asistohet nga projekti Bashki të Forta.

Arsimi, konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Durrës. Bashkia Durrës ka bërë hapa të mëdha përsa i përket infrastrukturës së kopshteve dhe mbarëvajtjes së tyre, megjithatë nevoja për përmirësim është prezente, për të ofruar shërbim cilësor në Arsimin Parashkollor. Plani i përmirësimit synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha aktivitetet zbatuese në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa objektiva strategjike.

Gjatë analizimit të të dhënave, vihet re që një nga problematikat e Bashkisë së Durrësit është infrastruktura e pa përshtatshme për fëmijët përsa i përket godinave të kopshtit kryesisht pranë Njesisë Administrative Manëz, vetëm në tre prej godinave egzistuese, kopshti Kameronas, në varësi të shkollës 9 vjeçare "Riza Shera" Radë, kopshti Hamallaj dhe kopshti Shkallë në varësi të shkollës 9 vjeçare Armathë.

Bashkia Durrës ka investuar në përmirësimin e kushteve infrastrukturore të godinave të arsimit parashkollor në Bashkinë Qendër, ndërkohë që është duke parë me prioritet edhe godinat pranë Njesisë Administrative që ndodhen në ambientet e shkollave. Aktualisht, Bashkia nuk e ka përfunduar ende procesin e ri-ndërtimi dhe ri-konstruksioni të të gjitha godinave arsimore që janë prekur nga tërmeti.

1. Arritjet përgjatë zbatimit të planit të përmirësimit 2021-2023 si dhe kontributi i Bashkisë Durrës.

Bashkia Durrës, si një ndër 6 bashkitë pilot në komponentin e Arsimit Parashkollor, është angazhuar që në krye të herës me projektin Bashki të Forta, duke dhënë kontributin e saj si në identifikimin e hendekut ligjor me transferimin e këtij shërbimi tek pushteti vendor, po ashtu dhe në identifikimin e problematikave të operimit të këtij shërbimi dhe mundësinë e përmirësimit të kushteve infrastruktore të godinave të kopshteve si dhe mësimdhënies dhe të nxënit për fëmijët e moshës 3-6 vjec. Më poshtë, po paraqesim disa prej ndërhyrjeve dhe arritjeve të Bashkisë Durrës në arsimin parashkollor.

- Kontribut në hartimin e dokumentit “Analiza e proceseve të arsimit parashkollor (manualit) në Shqipëri”, i cili ndihmon të kuptohet çfarë bashkitë dhe institucionet qendrore duhet të bëjnë për arsimin parashkollor sipas ligjshmërisë dhe standardeve kombëtare.
- Analiza e situatës dhe gjendjes së arsimit parashkollor në Bashkinë Durrës në bashkëpunim me Bashki të Forta.
- Plani i përmirësimit të shërbimit të arsimit parashkollor i miratuar.
- Shtimi i strukturës së Sektorit të Arsimit në Bashkinë Durrës.
 - Emerimi i një punonjësi të dedikuar për AP në sektorin e arsimit pranë bashkisë Durrës.
 - Shtimi i një inxhinieri në strukturën e sektorit të arsimit pranë bashkisë Durrës
- Në zbatim të planit të përmirësimit të shërbimit të AP lindi nevoja e krijimit të sektorit psiko- social dedikuar vetëm për kopshtet.
 - Punesimi i 4 psikologëve për shërbimin në kopshtet e bashkisë Durrës.
- Hartimi dhe miratimi i taksës së përkoheshme në Arsim Parashkollor – taksë që aplikohet vetëm në biznesin e madh dhe që do të përdoret për ndërtim godinash për kopshtet në Njësi Administrative, mjete didaktike dhe / ose kende lojrash për fëmijët e kopshteve. Vendosja e taksës u krye sipas ligjshmërisë duke organizuar 3 dëgjesa publike.
- Shtimin e 2 kopshteve me dreke si kërkesë e komunitetit.
- Punësimi i 10 mësues ndihmës.
- Rritja e kapaciteteve të drejtuesve të kopshteve dhe mësuesve nëpërmjet trajnimeve. Kontributi në dokumentin e MAS për “Standardet e drejtorit të Arsimit Parashkollor”
- Themelimi i Keshillit të Prinderve dhe Bordeve aty ku mungonte.
- Fuqizimi i bordeve dhe këshillave të prinderve përmes aktiviteteve të ndryshme (si zë i fortë në dëgjesat publike për miratimin e planit të përmirësimit) dhe trajnimeve.
- Angazhim dhe fitimi i çmimit të publikut me praktiken “Unë të dëgjoj”, lidhur me praktikën e mira për fëmijët e grupmoshave 3-6 vjeç.
- Pyetësori për prindërit lidhur me kënaqësinë e shërbimit në AP, i cili u inicua nga Komisioni i Barazisë Gjinore dhe i Arsimit, por i shërben edhe bashkisë për të kuptuar fushat ku duhet të investojë më shumë, i shërben transparencës dhe llogaridhënies dhe një bashkie më afër qytetarëve. Gjetje kryesore: përmirësimi i infrastruktures në kopshtet në Njësitë Administrative, kthimi i më shumë kopshteve me drekë, përmirësimi i menuesë së ushqimit.

Taksa e përkohshme e arsimit në Bashkinë Durrës.

Taksa e përkohshme e arsimit u vendos për biznesin e madh me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 160 datë 23.12.2021, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2022”, në vlerën 12 mijë lekë në vit.

Me këtë taksë, bashkia Durrës:

1. Do të rris cilësinë e arsimit në godinat arsimore, në fshtara të zonave të thella të bashkisë Durrës, pasi atje infrastruktura lë për të dëshiruar.
2. Duke ndërtuar kënde lojërash, terrenet sportive për fëmijët në ambjentet dhe godinat arsimore që kanë hapësira të mjaftueshme.

Nga fondet e mbledhura nga taksa e përkohshme për arsimin, është realizuar ndërtimi i kopshtit dhe shkollës fillore (5 klasa shkolle fillore dy klasa kopësht), Jusuf Hoti në Katundin e Ri, i cili u ndërtua me donatorë dhe bashkëfinancim nga Bashkia Durrës në vlerën 43 milion e 680 mijë lekë, nga të cilat kësti i parë i mbledhur nga taska është në vlerën 20.000.000 leke dhe kësti i dytë në vlerën 23.680.000 leke.

Qëllimi

Plani 2024-2026 do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Durrës dhe ai synon të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme proceset që lidhen me arsimin parashkollor. Konkretisht nëpërmjet planit synohet:

- Planifikim strategjik përsa i përket riorganizimit të infrastrukturës së kopshtit, me qëllim përsimulimin e shërbimit në kopshtet që janë brenda shkollave, ose kopshteve që kanë nevojë imediate për restaurim, vecanërisht ato në Njësitë Administrative;
- Zhvillimi i burimeve njerëzore të bashkisë në çështje të arsimit parashkollor, përmes ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet e drejtimit dhe administratës së bashkisë për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të përmirësimit;
- Finalizimi i rregullores së funksionimit të kopshteve dhe organizimit të shërbimit në bashki si dhe implementimi i tyre.
- Bashkëpunimi i ngushtë me prindërit dhe komunitetin, për të ndërgjegjësuar për rëndësinë që ka kopshti në zhvillimin e fëmijës;
- Shtim personeli edukativ dhe mbështetës.
- Mbledhja dhe zbatimi i taksës së përkohshme në Arsimin Parashkollor përgjatë vitit 2024.
- Kthimin e 3 kopshteve me drekë si kërkesë e komunitetit në Njësitë Administrative të Bashkisë Durrës, specifikisht, kopshti me ushqim Isuf Ferra, Nishtullë, Durrës, kopshti me ushqim Rreze Drite, në fshatin Kuçok, NJA, Manëz dhe kopshti Lulet e Pranverës, tek blloku i banesave të reja nga rindërtimi, Manëz.

Më poshtë paraqitet një analizë përmbajtësore e cila do të përmbajë Vizionin, Misionin, Objektivat Strategjik të Planit, personat përgjegjës për implementimin, monitorimin dhe zhvillimin e tij si edhe gjëndjen aktuale, analitike statistikore të kopshteve për vitin akademik 2023-2024.

Shtrirja

Plani synon të përmirësojë shërbimin e Arsimit Parashkollor në Bashkinë e Durrësit përgjatë viteve 2024-2026. Plani do të implementohet në të gjitha kopshtet që ka nën juridikson Bashkia Durrës. Për mbarëvajtjen e aktiviteteve në plan dhe monitorimin e tij do të kujdeset Sektori i Arsimit, pranë Drejtorisë së Arsimit Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare.

Vizioni

Përmirësimi i shërbimit të Arsimit Parashkollor, nëpërmjet strukturave për arsimin parashkollor, fuqizimin e tyre për t'ju përgjigjur nevojave të fëmijëve si dhe përmirësimin e kushteve infrastruktore dhe arritjen e standarteve për një shërbim cilësor për fëmijët e kopshteve, mosha 3-6 vjec.

Misioni

Shtimi i ambienteve arsimore si dhe kopshteve me ushqim, për arsimin parashkollor dhe përmirësimi i cilësisë së tyre për të ofruar shërbim cilësor për çdo fëmijë të arsimit Parashkollor.

Objektivat

- Përmirësimi i infrastrukturës së kopshteve veçanërisht në kopshtet e Njërive Administrative.

Përgjegjësitë

1. Koordinator i planit:
 - Personi përgjegjës për Sektorin e Arsimit, i cili kujdeset për zbatimin e planit nga të gjithë aktorët përgjegjës;
2. Aktorët zbatues të planit:
 - Drejtues kopshtit;
 - Mësues i kopshtit;
 - Staf mbështetës i kopshti;
 - Strukturat prindërore të thelemeluara pranë kopshteve.
 - Shërbimi psiko-social,
 - Drejtoria e Burimeve Njerëzore
 - Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit;
 - Sektori i Arsimit;
 - Sektori i Prokurimeve;
 - Donatorë.
3. Monitorues/vlerësues i planit:
 - Kryetari i Bashkisë;
 - Këshilli i Bashkisë.

2. Të dhëna për arsimin parashkollor në Bashkinë Durrës

2.1 Qëllimi

Proceset e menaxhimit nuk janë pjesë e ekzekutimit të menjëhershëm të detyrave, por vendosin objektiva strategjike dhe kushte kuadër që ndikojnë në llojet e tjera të procesit. Këto përfshijnë planifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë (ushqimi dhe trajnimi i stafit për rritjen e cilësisë në mësimdhënie).

Planifikimi i të gjithë sistemit parashkollor mbështetet në numrin e parashikuar të fëmijëve në moshën e kopshtit 3-6 vjeç, normën e pritshme të regjistrimit, si dhe shkallën e pritshme të frekuentimit. Kjo përbën planifikimin e kërkesës së arsimit parashkollor, duke marrë parasysh që arsimi parashkollor nuk është i detyrueshëm në Shqipëri.

Procesi i parashikimit ka gjithashtu edhe dimensionin e ofertës, që përfshin vlerësimin e numrit të mësuesve të nevojshëm, drejtorëve, mësuesve mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara, stafit mbështetës, si dhe objekteve (mjediseve), stafit shtesë etj.

Plani i përmirësimit të shërbimit në Proceset e Menaxhimit ka si qëllim përmirësimin e shërbimit të kopshtit duke siguruar ulje të numrit të fëmijëve në kopshtet e mbipopulluara; rritje të regjistrimeve në kopshtet nën kapacitet; ulje të numrit të grupeve të përziera dhe fëmijëve në to, themelimin dhe fuqizimin e organizmave brenda institucionit të kopshtit.

2.2 Të dhëna të përgjithshme

Bashkia Durrës ka në administrim 56 kopshte me një numër prej 3350 fëmijë, nga këto 11 kopshte me ushqim me 1379 fëmijë dhe 45 pa ushqim me 1971 fëmijë, 14 kopshte në qytet dhe 31 kopshte shkollash në Njësitë Administrative. Ka 42 shkolla 9 vjeçare me gjithsej 15205 nxënës. Bashkia e ka funksion të vetin arsimin parashkollor (AP) që nga Janari 2016. Në arsimin parashkollor ka 210 punonjës edukativ, dhe 170 punonjës ndihmës, gjithsej 380 punonjës. Shërbimet që ofrohen janë: pagat dhe sigurimet e punonjësve, si kombinim i transfertës së pakushtëzuar sektoriale me të ardhurat e Bashkisë, mirëmbajtje të godinave arsimore, me paisje elektrike hidraulike, paisje me orendi e paisje kur ato janë tejet të amortizuara apo kur kemi ndërtime të reja me fondet e bashkisë, uje energji etj., investimet (rikonstruksion apo ndërtime të reja në këtë program), gjithashtu ushqimi dhe shërbimi psikosocial në arsimin parashkollor.

Të dhënat e kopshteve për vitin 2023-2024

	Nr.	Kopshti	Nr.i grupeve të kopshtit	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi 4	Grupi 5	Grupi 6	Nr. i fëmijëve të regjistruar	Nr. i fëmijëve që frekuentojnë kopshtin	Femije vajza	Femije djem	Femije rom	Femije egjiptian	Femije me AK	Nr. I Eduktorëve	Nr I mesuesve	Kuzhinierë	N/Kuzhinierë	Sanitare	Lavantierë	Roje	Punonjese shërbimi total	
Kopshte me dreke	1	"I Maji"	4	41	39	41	36			157	157	80	77	7	0	4	8	1	1	1	3	0	0	5	
	2	"7 Marsi"	6	41	39	42	46	34	36	238	238	107	131	0	1	0	12	1	1	2	3	1	0	7	
	3	"I"	4	31	41	38	42			152	152	80	72	0	0	1	8	1	1	1	2	0	0	4	
	4	"Sotir"	4	25	26	26	25			102	102	52	50	0	5	1	8	1	1	1	2	0	0	4	
	5	"Parafabrik"	4	32	36	36	39			143	143	80	63	0	5	0	9	0	1	1	2	0	0	4	
	6	"Fidanishte"	4	36	38	42	42			160	158	68	90	0	9	5	8	1	1	1	3	0	0	5	
	7	"Hasan"	6	25	25	34	29	30	26	169	169	83	86	0	2	4	11	1	1	1	2	0	0	4	
	8	"Fotomoneu"	4	28	29	23	24			104	104	44	60	0	6	0	8	1	1	1	2	0	0	4	
	9	"Met"	6	26	25	27	27	23	26	154	154	74	80	0	3	0	12	1	1	1	3	0	1	6	
	10	"Neim Babameto"	4	30	30	26	29			115	115	62	53	0	0	2	6	0	1	1	2	0	0	4	
Kopshte pa dreke	11	"Duresi i R"	5	25	24	24	23	24		120	120	60	60	1	3	1	5	1	0	0	2	0	0	2	
		TOTALI	51	340	352	359	362	111	88	1614	1612	790	822	8	34	18	95	9	10	11	26	1	1	49	

Të dhënat e kopshteve ne Shkolla për vitin 2023-2024																			
Nr.	Kopshti/Shkoll a	Nr.i grupeve të kopshtit	Grupi I pare	Grupi I dyte	Grupi I trete	Grupi I katert	Nr. i fëmijëve të regjistru ar	Nr. i fëmijëve që frekuent ojnë kopshtin	Femije vajza	Femije djem	Femije rom	Femije egjiptian	Femije me AK	Nr. I Eduktor eve	Nr. I mesuese ve ndihmes e	Sanitare	Nr. I rojeve	Nr. I punonjes eve te sherbimi t	Kamera sigurie
2	"Bajram Curri 1"	2	20	25			45	45	22	23	0	0	0	2	0	3	0	3	3
3	"Abedin Dino"	4	25	30	25	30	110	110	57	53	0	1	3	4	1	1	0	1	jo
4	"Isuf Ferra"	2	21	23			44	44	19	25	3	1	0	2	0	2	1	3	po
5	"Eftali Koci"	1	35				35	35	20	15	4	0	0	1	0	2	1	3	0
6	"Demokracia"	2	20	20			40	40	19	21	0	0	0	2	0	3	1	4	0
7	"14 Nentori"																	0	
8	"Jan Kukuzeli"	1	22				23	22	8	14	0	1		1	0	2	2	4	po
9	"Marie Kaculini"	2	27	22			49	49	26	23	0	7	2	2	1	3	1	4	11
10	"Kushtrimi i Lirise"	1	26				26	26	12	14	0	0	0	1	0	3	0	3	0
11	"Qemal Mici"	4	26	26	26	26	104	104	47	57	0	3	2	4	0	3	1	4	Po
12	"Hajdar Dushi"	1	22				27	27	9	18	0	4	0	1	0	2	0	2	0
13	"Met Hasa"	2	13	12			25	25	10	15	0	0	0	1	0	1	0	1	po
14	PLM	1					5	5										0	
	TOTALI	23	257	158	51	56	533	532	249	278	7	17	7	21	2	25	7	32	

Të dhënat e kopshteve në Njësi Administrative për vitin 2023-2024																				
Nr.	Kopshti/Shkolla	Nr.i grupeve të kopshtit	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi 4	Nr. i fëmijëve të regjistruar	Nr. i fëmijëve që frekuentojnë kopshtin	Femije vajza	Femije djem	Femije rom	Femije egjiptian	Femije me AK	Nr. I Eduktorëve	Mesues e ndihmese	Psikolog e	Nr. I pastruesve	Nr. I rojeve	Punonjë e te tjera sherbimi	Punonjë s sherbimi gjithsej
	NJA RRASHBULL 6 kopshte	15	112	139	47	21	321	319	146	173	3	0	2	15	0	1	10	1	0	11
1	9 vj "Vellezerit Haradinaj"	3	15	25	26		66	66	34	32	0	0	1	3	0	0	2	0		2
2	MB "Besnik Hidri", Shenvlash	2	16	22			40	38	21	17	0	0	0	2	0	0	2	0		2
3	9 vj St.Zooteknik Xhafzotaj	4	29	25	21	21	96	96	46	50	3	0	0	4	0	0	2	1		3
4	9 vj "Hamza Muca", Shkallnur	2	21	24			45	45	22	23	0	0	0	2	0	0	1	0		1
5	9 vj "Shefqet Ndroqi", Rromanat	2	15	13			28	28	11	17	0	0	1	2	0	1	1	0		1
6	9 vj "Myslim Hidaj", Arapaj	2	16	30			46	46	12	34	0	0	0	2	0	0	2	0		2
	NJA ISHEM 6 kopshte	9	100	26	16	0	142	142	69	73	0	0	1	9	0	0	6	1	0	7
7	9 vj "Adem Gjeli",Gjuricaj dhe fushe Gjuricaj	1	32				32	32	14	18	0	0	0	1	0	0	1	0		1
	9 vj "Pren Simoni"	3	36	0	0	0	36	36	18	18	0	0	0	3	0	0	1	0		1
8	9 vj "Pren Simoni", Bize	1	12				12	12	6	6	0	0	0	1	0		1	0		1
9	9 vj "Pren Simoni", Drac	1	14				14	14	8	6				1	0		0	0		0
10	9 vj "Pren Simoni", Fushe Drac	1	10				10	10	4	6				1	0		0	0		0
11	9 vj "Xhelal Shtufi",Shkafane	3	12	12	16		40	40	19	21	0	0	0	3	0	0	2	1		3
12	MB "Rexhep Mezini", Ishem	2	20	14			34	34	18	16	0	0	1	2	0	0	2	0		2
	NJA KATUND I RI 7 kopshte	12	127	84	0	0	211	211	98	113	0	1	0	12	0	0	11	0	0	11
13	Shkolla MB "Jusuf Hoti" Katund i Ri	2	12	14			26	26	14	12	0	0	0	2	0	0	3	0		3
14	Shkolla 9-vjecare Jube	1	24				24	24	12	12	0	0	0	1			1	0		1
15	Shkolla 9-vjecare Bishtkamez	1	23				23	23	10	13	0	0	0	1	0	0	1	0		1
	Shkolla 9-vjecare "Bajram Gashi",Flake	2	11	14			25	25	12	13	0	0	0	2			1	0		1
17	Shkolla 9 vj Fshat Rinia	2	20	26			46	46	21	25	0	0	0	2	0	0	2	0		2
	Shkolla 9-vjecare "Artan Zeka", Qerret	2	17	11			28	28	11	17	0	0	0	2			1	0		1
19	Shkolla 9-vjecare Sukth	2	20	19			39	39	18	21	0	1	0	2			2	0		2
	NJA SUKTH 6 kopshte	16	127	138	92	23	384	380	186	194	3	2	2	17	0	1	11	2	2	13
20	Sh 9 vj"Pal Zefi" Rrushkull	2	22	22			44	44	23	21	0	0	0	2			2	0		2
21	Sh 9 vj Hamallaj	2	18	13			31	31	18	13	0	1	0	2	0	0	2	1		3
22	Perlat	2	10	13			23	23	13	10	0	0	0	2	0	0	1	0		1
23	MB "Ismet Nanushi" Kulle	3	31	34	35		100	100	49	51	3	1	0	3	0	0	3	0		3
24	Shk 9 vj Vardardhe	3	23	23	26		76	72	37	35	0	0	1	3	0	0	2	0		2
25	Shk 9 vj"Njazi Mastori", Sukth	4	23	33	31	23	110	110	46	64	0	0	1	5	0	1	1	1	2	2
	NJA MANEZ 6 kopshte+ 1 kopesht i ri	8	89	22	25	0	136	136	56	80	0	0	0	8	0	0	2	0	0	2
26	Shkolla 9-vjecare "Zyber Sallaku",Kucok	3	18	22	25		65	65	29	36	0	0	0	3			0	0		0
	Shkolla 9-vjecare "Riza Shera", Rade (2 kopshte)	2	35	0	0	0	35	35	19	16	0	0	0	2	0	0	0	0		0
27	Kopshti Rade	1	25				25	25	14	11	0	0	0	1			0	0		0
28	Kopshti Kamas	1	10				10	10	5	5	0	0	0	1			0	0		0
	Shkolla 9-vjecare Armathe(3 kopshte,Hamallaj,Armathe,Shkalle)	3	36	0	0	0	36	36	8	28	0	0	0	3	0	0	2	0		2
29	Kopshti Armathe	1	12				12	12	2	10	0	0	0	1	0		2	0		2
30	Kopshti Shkalle	1	10				10	10	3	7	0	0	0	1	0		0	0		0
31	Kopshti Hamallaj, Manez	1	14				14	14	3	11	0	0	0	1	0		0	0		0
	TOTALI	60	555	409	180	44	1194	1188	555	633	6	3	5	61	0	2	40	4	2	44

2.3 Qëllimi i Politikës së Programit

Për arsim cilësor në përputhje me objektivat dhe prioritetet vendore, strategjinë kombëtare të arsimit, nëpërmjet krijimit të mundësive për një zhvillim dhe shfrytëzim cilësor të infrastrukturës moderne dhe sipas standarteve të ambjenteve në kopshte.

Treguesit e performancës

- Rritja e numrit të fëmijëve që frekuentojnë arsimin parashkollor
- Rritja e numrit të fëmijëve në arsimin parashkollor
- Rritja e numrit të kopshteve/shkollave të reja apo të rikonstruara kundrejt totalit të shkollave 9 vjeçare
- Rritja e numrit të psikologëve për fëmijë në kopshte
- Ofrimi i shërbimit duke ruajtur numrin e mësuesve të arsimit parashkollor për fëmijë në kopshte (1 mësues/18 fëmijë)

Treguesit	2023	2024	2025	2026
Fëmijë që frekuentojnë kopshtin	3350	3400	3450	-
Rritja e numrit të fëmijëve në AP	45	50	50	-
Nr.shkollave/kopshteve të reja//rikonstruara me fondet e bashkisë	4	3	2	3
Nr.psikolog/fëmijë	1/845	1/845	1/682	1/682
Nr. mësues i arsimit parashkollor/ fëmijë	1 mësues/18 fëmijë	1 mësues/18 fëmijë	1 mësues/18 fëmijë	1 mësues/18 fëmijë

Objektivat e programit:

Objektivi 1- Të sigurohet rritja e aksesit të fëmijëve 3-6 vjeçarë nga viti në vit në arsimin parashkollor.

Objektivi 2- Të rritet çdo vit numri i fëmijëve Rom e Egjiptian që ndjekin arsimin parashkollor.

Objektivi 3- Përmirësimi i kushteve infrastrukturore dhe sigurimi i standarteve në arsimin bazë dhe parashkollor (rikonstruksione plus ndërtime të reja) të përfundojnë brenda vitit 2030 në të gjithë kopshtet dhe shkollat e Bashkisë Durrës.

Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2024-2026

- Në vitin 2024 numri i kopshteve do të jetë 57 (pesëdhjetëeshtatë) funksional pasi hapet për herë të parë një kopësht i ri me 5 grupe, me fondet e rindërtimit në Njësinë Administrative Manëz. Këto grupe do të hapen sipas kërkesave të komunitetit brenda periudhës 2024-2026.
- Në vitin 2024 numri i kopshteve me drekë do të jetë 14 duke lehtësuar shumë nënat të cilat do të mund të punojnë pasi sigurojnë fëmijët e tyre (aktualisht, janë 11 kopshte nga të cilat 10 në qytetin e Durrësit dhe 1 në NJA Sukth të cilave i shtohen 3 kopshte të tjera 2 në NJA. Manëz dhe 1 në Nishtulla Durrës që i takon komunitetit Rom dhe Egjiptian).
- Raporti fëmijë për mësues të arsimit parashkollor për vitin 2023 në kopshtet e Bashkisë Durrës është 18 fëmijë për 1 mësues të arsimit parashkollor, raport i cili duhet të mbahet i tillë edhe për vitet në vazhdim.
- Për realizimin e sa më sipër, numri i punonjësve në vitin 2024 në arsimin parashkollor do të shtohet me 14 punonjës (7 edukativ dhe 7 shërbimi), përkatësisht si më poshtë vijon:
 - Kopshti “Njazi Mastori”, NJA Sukth aktualisht me 100 fëmijë, 4 grupe kopshti, nga të cilët 1 grup është me ushqim. Në Shtator të vitit 2024 do të shtohet edhe një grup tjetër me ushqim, pra do të shtohet 1 punonjës edukativ.
 - Kopshti “Isuf Ferra” Nishtulla Durrës, Ndërtim i ri nga fondet e rindërtimit (UNDP), aktualisht ka 60 fëmijë, 3 grupe kopshti. Në prill 2024 do të kthehet në kopësht me ushqim fillimisht njëri nga grupet dhe në vitin 2025 edhe grupi tjetër në varësi të kërkesave të komunitetit. Në prill të vitit 2024 do të shtohen 2 punonjës edukativ (1 drejtues) dhe 3 punonjës ndihmës (1 kuzhinier, 1 nd/kuzhinier dhe 1 sanitare).
 - Kopshti “Zyber Sallaku” Kuçok, NJA Manëz, ka 60 fëmijë, 3 grupe kopshti. Në Prill të vitit 2024 shtesa do të jetë: 1 punonjës edukativ plus 3 punonjës ndihmës (1 kuzhinier, 1 nd/kuzhinier dhe 1 sanitare).
 - Kopështi Lulet e Pranverës, tek blloku i banesave të reja nga rindërtimi Manëz, në Prill të vitit 2024 do të hapen 2 grupe pa ushqim, prandaj do të vendosen 2 punonjës edukativ.
 - Shkolla e Mesme e Bashkuar “Ismet Nanushi” Kullë, në Janar të vitit 2024 është shtuar 1 personel edukativ pasi nga 80 fëmijë që kishte ky kopësht, numri i tyre ka arritur në 107 fëmijë në Nëntor 2023. Meqënëse kopshti është godinë e veçantë nga shkolla, në prill të vitit 2024 do të shtohet edhe 1 punonjëse shërbimi (sanitare).

Gjithashtu gjatë vitit 2025-2026 do të plotësohen respektivisht çdo vit edhe Njësitë Administrative me punonjës sigurie, gjithsej 24 punonjës.

Gjithsej numri shtesë i punonjësve në programin Arsimi bazë dhe Parashkollor: 09120 për vitin 2024 është 19 punonjës, nga të cilët vetëm për Arsimin Parashkollor do të ketë:

- **14 punonjës në arsimin parashkollor – 7 punonjës edukativ dhe 7 punonjës shërbimi**

Lista e projekteve dhe investimeve për institucionet arsimore – kopshtet, përgjatë periudhës 2024-2026

Nr. 001	Projekti: Organizimi i aktiviteteve të përbashkta mes komunitetit dhe kopshteve	Programi Buxhetor: 09120 – Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
<p>i Situata</p> <p>Përfshirja e komunitetit në vendimmarrje ose aktivitete që lidhen me Arsimin Parashkollor konsiderohet shumë i rëndësishëm për rritjen e numrit të fëmijëve në kopshte. Në Njësitë Administrative numri i fëmijëve të regjistruar është më i ulët se në bashkinë qendër. Ky fakt mund të vijë si pasojë e mentalitetit të prindërve mbi arsimin parashkollor si një faktor jo i rëndësishëm në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Për shkak të numrit të vogël të fëmijëve të regjistruar në kopshtet e Njërive Administrative, formohen grupet e përziera. Aktualisht, numri i grupeve të përziera është i lartë krahasuar me numrin e grupeve të I, II dhe III. Ky fakt shkakton vështirësi në edukimin dhe menaxhimin e fëmijëve.</p>		
ii Synimi i projektit		
<p>Një mënyrë për të zgjidhur këtë çështje është përfshirja e komunitetit në aktivitete të organizuara nga kopshtet. Në këtë mënyrë, pritet të rritet ndërgjegjësimi i komunitetit (përfshirë prindërit) për rëndësinë e arsimit parashkollor në formimin e fëmijëve dhe si pasojë pritet të rritet pjesëmarrja aktive në vendimmarrje, lobimi dhe theksimi i çështjeve që kanë nevojë të theksohen përsa i përket arsimit parashkollor.</p> <p>Nëpërmjet aktiviteteve të iniciuara nga Njësia e Arsimit Parashkollor dhe vënia në zbatim nga drejtuesit dhe mësuesit e kopshteve, synohet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillimi i fëmijëve. Në këto aktivitete, protagonistët kryesorë do të jenë fëmijët, duke recituar, treguar përralla, kërcyer, etj. Në këtë mënyrë, aftësitë e fëmijëve për të bashkëpunuar dhe mësuar gjëra të reja do të rriten; 2. Informimi i komunitetit. Këto aktivitete është mirë që të ndërthuren dhe me sesione të shkurtra informuese për rëndësinë që ka arsimit parashkollor te formimi i fëmijëve ose të jenë kryesisht me natyrë informuese. Përveç aktivizimit të fëmijëve, komuniteti do të njihet, nëpërmjet mësueseve, edhe me faktin se sa i rëndësishëm është arsimit dhe nevojën që ekziston që ky komunitet të jetë më aktiv në çështje të 		

arsimit parashkollor. Në këtë mënyrë, mund të llobohet prej tyre gjatë hartimit të buxhetit në Bashki për të rritur buxhetin e vendosur për kopshtet;

3. **Rritja e regjistrimeve.** Shumë prindër, duke e konsideruar kopshtin si një nivel jo të rëndësishëm të arsimit nuk i regjistrojnë ata në kopsht. Arsye të tjera të mos regjistrimit mund të jetë mos njohja e ambienteve të kopshteve, mësueset dhe stafin e kopshteve. Nëpërmjet aktiviteteve të organizuara nga kopshti, ata do të njihen me ambientet, mësueset, mënyrat e mësimdhënies, përfitimet e fëmijës nga kopshti dhe në këtë mënyrë synohet të rritet norma e regjistrimit;
4. **Ulja e grupeve të përziera dhe e numrit të fëmijëve në grupet e përziera.** Me rritjen e regjistrimit mund të ulet dhe numri i fëmijëve në grupet e përziera. Duke qenë se ato formohen kur numri i fëmijëve për të formuar grup të I, II dhe III nuk është i mjaftueshëm, rritja e normës së regjistrimit do të mundësojë zvogëlimin e numrit të grupeve të përziera dhe numrin e fëmijëve në këto grupe.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Menaxheriale

1. Kopshtet në bashkëpunim me Këshillin e Prindërve planifikon aktivitetet. Për të rritur sa më shumë partneritetin si me komunitetin por edhe motivimin e Këshillit të Prindërve për të qënë aktorë të rëndësishëm në zhvillimin e kopshtit, duhet që Bashkia të njohë disa pika kyçe të zonës ku është kopshti si p.sh.
 1. *Cilat janë karakteristikat kyçe dhe pikat e forta të komunitetit ku ndodhet kopshti?*
 2. *Çfarë mund të bëni ju dhe çfarë mbështetje kërkon ju për të mbështetur kopshtin në fusha të tilla si disiplinimi pozitiv, ndërgjegjësimi për rëndësinë e edukimit në moshë të hershme ?*
 3. *A ka partneritete të ndërtuara mes kopshtit dhe kulturave të ndryshme të komunitetit?*
2. Kalendari i aktiviteteve i dërgohet Njesisë së Arsimit Parashkollor;
3. Organizohen takime me komunitetin për krijimin e Grupit të Vullnetarëve.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

Shtator	Tetor-Dhjetor	Janar-Mars (vetëm për kopshtet e NJA)	Prill-Gusht (vetëm për kopshtet e NJA)
Prindërit dhe mësuesit takohen për të diskutuar: 1. Aktivitetet që do realizohen gjatë vitit;	Kopshti: -Planifikon aktivitetet bazuar te nevojat e fëmijëve dhe komunitetit. Prindërit: -Marrin pjesë tek aktivitetet që ata kanë	Në bashkëpunim me kopshtin dhe bashkinë, organizohen takime me komunitetin për të krijuar grupin e vullnetarëve (prindër, studentë, dhe pjestarë të tjerë të komunitetit). Grupi i vullnetarëve merr pjesë në	-Kopshti ofron aktivitete në ambient të hapur; -Komuniteti mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete;

<p>2. Nevojat që kanë fëmijët dhe komuniteti;</p> <p>3. Kopshti rrit informimin mbi rolin dhe përgjegjësinë e Këshillit të Prindërve.</p>	<p>shprehur dëshirën të jenë pjesëmarrës;</p> <p>-Informohen nga kopshti në mënyrë të vazhdueshme për planin që zhvillon kopshti.</p>	<p>organizimin e aktiviteteve të ardhshme.</p>	<p>-Prindërit ndihmojnë fëmijën në ndjekjen e detyrave.</p>
<p>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rritja e normës së regjistrimit të fëmijëve në kopsht; 2. Angazhim më i madh i Këshillit të Prindërve në kopsht; 3. Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi rëndësinë e arsimit parashkollor dhe nevojën për të pasur më shumë përfshirje nga ana e tyre. 			
<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sektori i Arsimit 	<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komuniteti • Kopshti • Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës • Gjinnazet 		
<p>f) Periudha e zbatimit: 2024-2026</p>	<p>g) Ndjek zbatimin e projektit: Sektori i Arsimit</p>		

Nr. 002	Projekti: Vlerësimi i Brendshëm i kopshteve	Programi Buxhetor: 09120 -Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
---------	--	---

a)Përshkrim i shkurtër i projektit

i Situata

Aktualisht, nuk ekziston një metodë e unifikuar për vlerësimin e brendshëm të kopshteve. Vlerësimi i brendshëm ka si synim të analizojë pikat e forta, mundësitë për përmirësime dhe faktorët që kanë favorizuar ose penguar cilësinë. Vetëvlerësimi, në asnjë rrethanë, nuk duhet të bëhet qëllim në vetvete. Ai bëhet shumë më i fuqishëm, kur rezultatet transformohen në një plan zhvillimi. Plani duhet të identifikojë fusha dhe probleme që kërkojnë ndryshim dhe zgjidhje të reja, gjithashtu, duhet të identifikojë edhe objektivat, procedurat, burimet njerëzore dhe financiare për procesin e ndryshimit.

Vetëvlerësimi ka qëllim matës, kur plani i veprimit ka qëllim përmirësimin e cilësisë. transparenca e proceseve dhe rezultateve siguron automatikisht strategji komunikimi, nëpërmjet një publikimi aktiv.

Qëllimi i metodologjisë së vlerësimit të brendshëm është të drejtojë, të orientojë, të lehtësojë mësuesit, organizmat kolegjalë të kopshtit, drejtuesit e kopshtit, për të vlerësuar veten, me qëllim ndërgjegjësimin e të gjithëve aktorëve të kopshtit, sepse ata janë forca më e qenësishme, më e qëndrueshme e ndryshimit për përmirësimin e kopshtit.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Sipas Urdhërit nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, vlerësimi i brendshëm:

1. përfshin të gjithë punonjësit arsimorë të institucionit, psikologun, punonjësin social, oficerin e sigurisë dhe sekretarin;
2. kryhet çdo vit;
3. mbulon të gjitha fushat që përfshin monitorimi dhe vlerësimi i IA-së;
4. vlerësimi i brendshëm kryhet në nivel individual (drejtori, mësuesi, psikologu) dhe në nivel organizmash.

ii Synimi i projektit

Vlerësimi i brendshëm i kopshteve ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar nga ana e tij, nëpërmjet analizës dhe reflektimit për arritjet dhe mundësitë për përmirësime. Ky projekt ka si synim hartimin e një metode të unifikuar për të gjithë kopshtet për të kryer çdo vit vlerësimin e brendshëm. Gjithashtu është shumë e rëndësishme të përcaktohen fushat mbi të cilat realizohet vlerësimi i brendshëm. Përvoja ka treguar që duhet që vlerësimi i brendshëm të ketë të njëjtat fusha mbi të cilat realizohet vlerësimi i jashtëm i kopshtit.

Bashkia ka planifikuar që në vitin 2024 të gjithë kopshtet të kenë rregulloren e tyre në mënyrë që të ndihmojë kopshtet edhe në vlerësimin e brendshëm.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Nxjerrja e Urdhrit nga Kryetari i Bashkisë, për realizimin e vlerësimit të brendshëm nga drejtuesit e kopshtit.

B: Menaxheriale

1. Bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit të Brendshëm (Urdhër nr. 54, datë 26.05.2020 “Për miratimin e paketës së vlerësimit të cilësisë së shkollës”) ASCAP harton pyetësorë për mësuesit, prindërit dhe drejtorët e kopshteve/përgjegjësit e kopshteve për të kryer vlerësimin e brendshëm;
2. Drejtuesi i kopshtit organizon një fokus grup me personat me përgjegjësi prindërore, mësuesit dhe anëtarë të tjerë të organizmave të kopshtit për të diskutuar për një numër të vogël temash ose aspektesh që lidhen me kopshtin. Fokus grupi zhvillohet në periudhën kohore të pranuar nga të gjithë anëtarët dhe ka 6-8 pjesëmarrës;
3. Rezultatet mund të përdoren për hartimin e planit afatmesëm të kopshteve ose planeve vjetore.
4. Përfshirja në rregulloren e kopshteve në mënyrë që të shërbejë si bazë në procesin e vlerësimit të brendshëm të kopshteve.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i pyetësorëve për prindër, mësues dhe drejtues të kopshteve nga bashkia;
2. Organizimi i fokus grupeve;
3. Analiza dhe raportimi i rezultateve.
4. Rregullore e përditësuar.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Kryerja çdo vit e vlerësimit të brendshëm të kopshteve sipas udhëzimit të posaçëm të MASR;
2. Nxitja për vet-përmirësim i mësuesve, drejtuesve dhe organizmave të kopshteve;
3. Planifikimi më objektiv bazuar në rezultatet e vlerësimit të brendshëm.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Sektori i Arsimit.

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- Donator
- ZVAP;
- ASCAP.

f) Periudha e zbatimit:

2024-2026

g) Ndjek zbatimin e projektit:

Sektori i Arsimit

2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor

2.4.1 Bordi i Kopshtit

Informacion i përgjithshëm

Në bashkinë Durrës me përjashtim të kopshteve që kanë një ose dy grupe brenda shkollave, të gjitha kopshtet e tjera kanë themeluar Bordin e Kopshtit.

Referuar Udhëzimit Nr. 25, datë 25.07.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”, bordi përbëhet nga 7 anëtarë, ndërkohë në kopshtet publike të Qytetit Durrës, numri minimal i anëtarëve të bordit të kopshtit është 4, numri mesatar është 6, ndërsa numri maksimal i anëtarëve është 9.

Bordi mbledhet jo më pak se tri herë në vit. Mbledhjet e tjera zhvillohen me nismën e kryetarit të bordit ose të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij. Ndërkohë, në bashkinë e Durrësit, numri minimal i mbledhjeve të bordit në kopshtet publike të qytetit është 2, numri mesatar është 3, ndërsa numri maksimal është 5.

Disa nga veprimtaritë që kryhen dhe tematikat që diskutohen në bord janë:

Merrë pjesë në procedurat e emërimit e të largimit të drejtuesit të institucionit arsimor dhe anëtarëve të bordit.

Shqyrton rregulloren e brendshme të institucionit.

Ndjekë përmbushjen e objektivave të planit vjetor të institucionit.

Kontributi vullnetar i prindërve.

Nevojat imediate të fëmijëve.

Transporti i fëmijëve.

Siguria e fëmijëve.

Infrastruktura.

Objektiva kryesore:

Themelimi dhe fuqizimi i Bordit të Kopshtit si organizëm që siguron mbarëvajtjen e arsimit parashkollor dhe adreson çështjet problematike për zgjidhjen e tyre.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Themelimi i Bordit të Kopshtit në çdo kopsht

Nr	Pershkrimi
2	Rritja e aktivizimit të Bordit të Kopshtit në adresimin e problematikave të kopshtit
3	Adresimi i çështjeve të diskutuara në organizmat e kopshteve në Bashki.

Lista e projekteve

Nr. 003	Projekti: Krijimi i Bordit të Kopshtit sipas Udhëzimit nr. 25.	Programi Buxhetor: 09120 -Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
<p>Jo të gjithë kopshtet në Bashkinë Durrës kanë themeluar Bordin e Kopshtit. Kjo mungesë vihet re kryesisht në kopshtet të cilat janë në godina shkollash dhe që kanë drejtues drejtorin e shkollës.</p> <p>Referuar Udhëzimit Nr. 25, bordi përbëhet nga 7 anëtarë, ndërkohë në kopshtet publike të Qytetit Durrës, numri minimal i anëtarëve të bordit të kopshtit është 4, numri mesatar është 6, ndërsa numri maksimal i anëtarëve është 9.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Bordi i Kopshtit ka si synim të sigurojë që shërbimi arsimor të kryhet sipas politikave arsimore kombëtare e lokale dhe interesave të komunitetit nëpërmjet njohjes së problemeve, zgjidhjes ose adresimit për zgjidhjen e tyre. Bordi kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor në përputhje me aktet ligjore në fuqi.</p>		
ii Synimi i projektit		
<p>Është e nevojshme të ndërhyet për të themeluar Bordin e Kopshtit në kopshtet që ende nuk e kanë themeluar.</p> <p>Nëpërmjet këtij projekti synohet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Themelimi i Bordit në të gjitha kopshtet sipas Udhëzimit nr. 25 		
iii Niveli i ndërhyrjes		
B: Menaxheriale		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Pas regjistrimit të fëmijëve dhe fillimit të procesit mësimor të kopshteve, Sektori i Arsimit, njofton nëpërmjet një shkrese zyrtare me e-mail drejtuesit/kryemësuesit për themelimin e Bordit të Kopshtit brenda një afati 10 ditor. 2. Themelimi i Bordit të Kopshtit në kopshte dhe dërgimi i organogramës së Bordit në Bashki. 		

<p>3. Drejtuesi i kopshtit njofton Sektorin e Arsimit sa herë që Bordi i Kopshtit mblidhet dhe çështjet që diskutohen duke i dërguar procesverbalët ose dokumente të tjera shtesë të mbajtura nga Sekretari i Bordit.</p>	
<p>iv Aktivitetet kryesore të projektit</p> <p>1. Themelimi i Bordit të Kopshtit në çdo kopsht sipas Udhëzimit nr. 25</p>	
<p>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</p> <p>1. Krijimi i Bordit dhe funksioni i plotë i tij në çdo kopsht; 2. Rritja e monitorimit të Bordit të Kopshtit nga ana e Bashkisë;</p>	
<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sektorin e Arsimit • Kryetari i Bashkisë 	<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bordi i Kopshteve • Drejtuesit e Kopshteve
<p>f) Periudha e zbatimit: 2024-2025</p>	<p>g) Ndjek zbatimin e projektit: Sektorin e Arsimit</p>

2.4.2 Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit

Informacion i përgjithshëm

Sipas Urdhrit Nr.31.datë 28.01.2020, çdo institucion duhet të ngrëjë Komisionin e tij.

Jo të gjithë kopshtet e kanë ngritur Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit.

Komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit ka në përbërje të tij edhe prindër të caktuar nga këshilli i prindërve. Kopshtet e NJA dhe që janë brenda godinave të shkollave menaxhohen nga drejtuesit e shkollave dhe kanë të integruar Komisionin e Shëndetit të tyre me Komisionin e Shkollës.

Objektiva kryesore:

Themelimi dhe fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit sipas Udhëzimit nr. 31.

Lista e projekteve

Nr. 004	Projekti: Ngritja e Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
<p>i Situata</p> <p>Sipas Urdhrit Nr.31, datë 28.01.2020, çdo institucion duhet të ngrejë Komisionin e tij.</p> <p>Pjesa më e madhe e kopshteve publike e kanë ngritur komisionin e shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit. Megjithatë, sipas të dhënave të raportuara nga bashkia, një pjesë e kopshteve nuk e kanë themeluar Komisionin e Shëndetit. Komisioni i Shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit ka në përbërje të tij edhe prindër të caktuar nga Këshilli i Prindërve.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Disa prej detyrave kryesore të Komisionit (<i>sipas Urdhërit nr. 31 "Miratimin e rregullores, për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë"</i>) janë: a) mbikëqyr rregullisht në institucionin arsimor kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së nxënësve dhe punonjësve dhe ruajtjen e mirëmbajtjen e mjediseve dhe të pajisjeve; b) identifikon nevojat për mirëmbajtje të institucionit; c) përcakton nevojat për ndreqje të vogla, shërbime, zëvendësime të pjesëve për shkak të dëmtimeve; ç) organizon veprimtari ndërgjegjësuese me nxënës, mësues dhe prindër për kushtet e ruajtjes së shëndetit, të sigurisë, mirëmbajtjes së mjediseve e pajisjeve të institucionit. Detyrat e mësipërme janë shumë të rëndësishme dhe mungesa e Komisionit bën që këto detyra të mos mbulohen fare ose të mbulohen pjesërisht.</p>		
ii Synimi i projektit		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Themelimi i Komisionit në çdo kopsht; 2. Informimi i Bashkisë rreth problemeve dhe tematikave, të cilat diskutohet në Komision, por që është e nevojshme ndërhyrja e Bashkisë për t'i dhënë zgjidhje. <p>iii Niveli i ndërhyrjes</p> <p>A: Ligjore</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nxjerrja e një Urdhri nga Kryetari i Bashkisë ku kompetencën për themelimin dhe monitorimin e Komisionit të Shëndetit e ka Sektori i Arsimit pranë Bashkisë. <p>B: Menaxheriale</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pas regjistrimit të fëmijëve dhe fillimit të procesit mësimor të kopshteve, Sektori i Arsimit, njofton nëpërmjet një shkrese zyrtare me e-mail drejtuesit për themelimin e Komisionit të Shëndetit brenda një afati 10 ditor. 		

<ol style="list-style-type: none"> 2. Themelimi i Komisionit të Shëndetit në kopshte dhe dërgimi i organogramës së Komisionit në Bashki. 3. Drejtuesi i kopshtit/mësuesi përgjegjës njofton Sektorin e Arsimit sa herë që Komisioni mbledhet dhe çështjet që diskuton. 	
iv Aktivitetet kryesore të projektit <ol style="list-style-type: none"> 1. Themelimi i Komisionit të Shëndetit çdo vit në çdo kopsht sipas Udhëzimit Nr. 31. 	
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) <ol style="list-style-type: none"> 1. Krijimi i Komisionit dhe funksioni i plotë i tij në çdo kopsht 	
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) <ul style="list-style-type: none"> • Sektori i Arsimit 	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)
c) Periudha e zbatimit: 2024-2026	d) Ndjek zbatimin e projektit: Sektori i Arsimit

3. Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

3.1 Qëllimi

Proceset mbështetëse janë procese që ofrojnë mbështetje për proceset kryesore. Proceset mbështetëse duhet të gjenden brenda ose jashtë institucionit. Në shembullin e kopshtit, një proces mbështetës mund të jetë shtimi i burimeve njerëzore pranë Bashkisë, për të koordinuar në aktivitetet e planit të përmirësimit të arsimit parashkollor.

Planet e përmirësimit të shërbimit kanë si qëllim ofrimin e shërbimit sa më efikas të kopshteve në aspektin e edukimit të fëmijëve, sigurisë së tyre, zhvillimit të tyre dhe sigurimin e aksesueshmërisë së shërbimit nga të gjithë. Plani fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës së godinave të kopshteve, formimin dhe ngritjen e kapaciteteve në mbështetje të arsimit parashkollor si dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve në të gjitha strukturat e arsimit parashkollor në të gjithë territorin që mbulon Bashkia Durrës.

3.2 Objektiva të përgjithshëm

Objektivi kryesor i planeve të përmirësimit të shërbimit në lidhje me Proceset Mbështetëse është arritja e standardeve të vendosura nga aktet ligjore përsa i përket numrit të stafit të kopshteve, rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së godinave, llojet e materialeve didaktike, cilësinë e ushqimit dhe sigurimin e aksesit në kopsht.

3.3 Burimet Njerëzore

3.3.1 Rekrutimi i stafit

Për shkak të kërkesës së lartë të prindërve për të rregjistruar fëmijët në kopshte si edhe rritjes së numrit të fëmijëve të rregjistruar në kopshte për 2023-2024, bashkia Durrës ka parashikuar në buxhetin e saj kthimin e disa kopshteve me drekë për tju përgjigjur nevojave të prindërve dhe komunitetit. Për këtë arsye, nevojitet shtimi i punonjësve në arsimin parashkollor. Si rezultat, bashkia Durrës ka parashikuar që në vitin 2024 të shtojë në total 14 punonjës për kopshtet të cilat do të kthehen me drekë.

Nr. 005	Projekti: Punësimi 14 punonjës në arsimin parashkollor – 7 punonjës edukativ dhe 7 punonjës shërbimi për arsimin parashkollor	Programi 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	Buxhetor: arsimin
Funksioni: 09			
a)Përshkrim i shkurtër i projektit			
i Situata			
Bashkia Durrës planifikon që në vitin 2024 të punësojë 14 punonjës në arsimin parashkollor – 7 punonjës edukativ dhe 7 punonjës shërbimi për menaxhimin e arsimit parashkollor.			

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje	
<p>Në vitin 2024 numri i kopshteve do të jetë 57 (pesëdhjetëeshtatë) funksional pasi hapet për herë të parë një kopësht i ri me 5 grupe, me fondet e rindërtimit në Njësinë Administrative Manëz. Këto grupe do të hapen sipas kërkesave të komunitetit brenda periudhës 2024-2026.</p> <p>Në vitin 2024 numri i kopshteve me drekë do të jetë 14 duke lehtësuar shumë nënat të cilat do të mund të punojnë pasi sigurojnë fëmijët e tyre që ndjekin arsimin parashkollor. Aktualisht, janë 11 kopshte nga të cilat 10 në qytetin e Durrësit dhe 1 në NJA Sukth, të cilave i shtohen 3 kopshte të tjera 2 në NJA. Manëz dhe 1 në Nishtulla Durrës që i takon komunitetit Rom dhe Egjiptian).</p>	
ii Synimi i projektit	
Ky projekt synon punësimin 14 punonjësve në shërbim të kopshteve të bashkisë Durrës	
iii Niveli I ndërhyrjes	
A: Ligjore	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimi në KB i buxhetit për pagën e punonjësve; 2. Firmosja e kontratës së punës mes Bashkisë Durrës dhe punonjësve. 	
B: Menaxheriale	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore shpall vendet e lira të punës në ëeb-in e Bashkisë Durrës. 2. Përzgjedhja e punonjësve sipas pozicioneve respektive; 3. Prezantimi i punonjësit të ri me stafin me të cilin do të bashkëpunojë, detyrat dhe përgjegjësitë e tij. 	
iv Aktivitetet kryesore të projektit	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimi në KB të buxhetit për punonjësit 2. Shpallja në ëeb e vendit të lirë të punës 3. Përzgjedhja e specialistit dhe firmosja e kontratës 	
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Menaxhim më efikas i shërbimit të arsimit parashkollor. 	
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)
<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Burimeve Njerëzore • Struktura Përgjegjëse për Arsimin në Bashki. • Drejtoritë e kopshteve 	
e) Shpenzimet e llogaritura në mijë lekë (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)	

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026	Total
1	Miratimi në KB të buxhetit për punonjësit	Struktura Përgjegjëse për Arsimin në Bashki bashke me drejtorine e Buxhetit	14	12,215,000			12,215,000
2	Shpallja në ëeb e vendit të lirë të punës	Drejtoria e Burimeve Njerëzore					
3	Përzgjedhja e specialistit dhe firmosja e kontratës	Drejtoria Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Arsim Kultures në Bashki dhe QEA					
			14	12,215,000			12,215,000
f) Periudha e zbatimit: 2024				g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Arsimit në Bashkinë Durrës dhe QEA			

3.4 Menaxhimi i godinave

3.4.1 Rikonstruksioni i kopshteve

Informacion i përgjithshëm

Pjesa më e madhe e kopshteve publike në territorin e Bashkisë Durrës ndodhen brenda godinave të shkollave. Bashkia Durrës ka në administrim 56 kopshte me një numër prej 3350 fëmijë, nga këto 11 kopshte me ushqim me 1379 fëmijë dhe 45 pa ushqim me 1971 fëmijë, 14 kopshte në qytet dhe 31 kopshte shkollash në Njësitë Administrative.

Gjithashtu, nga të dhënat e marra nga Sektori i Arsimit në Bashkinë rezulton se:

1. Gjatë vitit 2024, do të ndërtohen dy terrene sportive respektivisht një terren përpara kopshtit Abedin Dino, me 4 grupe, që është ndërtesë e vecantë pranë shkolles 9 vjeçare me të njëjtin emër dhe ka 4 grupe, si dhe një terren pranë shkolles 9 vjeçare Jusuf Puka, pasi të dyja shkollat nuk kanë palestër për fëmijët dhe nxënësit. Fondi i parashikuar për ndërtimin e terrenit sportiv është 10,000,000 lekë për çdo shkollë.
2. Përgjatë vitit 2024 do të ofrohet shërbimi i mirëmbajtjes në vlerën prej 4,000,000 lekë për kopshtet:
 - 7 Marsi
 - Fotomonobeu
 - Parafabrikat
 - Kopshti në shkollën 9 vjeçare” Bilal Golemi” Xhafzotaj NJ.A. Rrashbull, në katin e parë është kopshti me 110 fëmijë, me 4 grupe.
3. Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Demokracia ku ndodhet kopshti me dy grupe. Vlera e këtij investimi për kopshtin shkon 7,000,000 lekë
4. Rikonstruksion kopshti Shkallë në Njësinë Administrative Manëz, me vlerë 6,000,000, për periudhën 2024-2025.
5. Met Hasa ku janë dy grupe kopshti, me hyrje vecantë për peridhën 2024-2025.
6. Ndërtim i kopshtit Isuf Ferra me fondet e rindërtimit (UNDP), përgjatë vitit 2024.
7. Përfundimi i kopshtit Rreze Drite në Kuçok Manëz në prill të 2024 i cili është ndërtuar me Donatorë, në të cilin do shtohet personeli edukativ dhe ndihmës përmendur dhe me sipër.
8. Kopshti në bllokun e ri të banimit në NJA Manëz, me dy grupe pa ushqim për periudhën 2024 ku do të shtohet staf edukativ.

Objektivat kryesorë

Rikonstruksioni i godinave duke iu përmbajtur standardeve për hapësirat e kopshteve dhe facilitetet e nevojshme.

Nën objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Rikonstruksioni i godinave të kopshteve të cilat kanë nevojë për rikonstruksion

Lista e Projekteve

Nr. 006	Projekti: Rikonstruksion i Shkollës 9 vjeçare Demokracia ku ka kopësht me dy grupe dhe kopshti Shkallë në Njësinë Administrative Manëz	Programi 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	Buxhetor: arsimin
Funksioni: 09			
a)Përshkrim i shkurtër i projektit			
i Situata			

Shkolla 9 vjecare Demokracia (ku përfshihet dhe kopshti me dy grupe që gjendet në këtë shkollë) dhe kopshti Shkallë në Njësinë Administrative Manëz, kanë nevojë për rikonstruksion. Sektori i Arsimit pranë Bashkisë Durrës ka planifikuar rikonstruksionin e tij gjatë vitit 2024 -2025.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

VKM nr. 159, datë 01.03.2017, “Për miratimin e standardeve të projektimit të kopshteve”, ka për qëllim që të shërbejë si referencë për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, programimit, projektimit/dizajnit dhe ndërtimit të ndërtesave/hapësirave të reja të kopshteve apo në rehabilitimin e ndërtesave ekzistuese. Në të paraqiten standardet për godinat e kopshteve në rast se duhet të ndërtohen të reja ose të rikonstruktohen.

ii Synimi i projektit

Ky projekt synon përmirësimin e infrastrukturës së godinës së kopshtit bazuar në Standardet e VKM Nr. 159.

iii Niveli I ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Miratimi i buxhetit për përmirësimin e infrastrukturës së Kopshtit në KB.

B: Infrastrukturore

1. Rikonstruksion i shkollës dhe kopshtit që gjendet në atë ndërtesë si dhe kopshti Shkallë në Njësinë Administrative Manëz.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Miratimi i buxhetit në KB;
2. Hapja e Procedurës së Prokurimit Publik dhe gjetja e operatorit ekonomik;
3. Supervizimi dhe kolaudimi

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Kushte infrastrukturore të përshtatshme në kopshtin në përshtatje me VKM Nr. 159.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit;
- Sektori i Arsimit;
- Sektori i Prokurimeve.

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- Operatori Ekonomik;
- Donatorë

<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Infrastruktures dhe Projekteve Publike 							
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)							
N r	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktua l	Buxheti 2024	Buxhet i 2025	Buxhet i 2026	Total
1	Miratimi i planit të përmirësimit dhe buxhetit në KB për të dy kopshtet	Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit/ Drejtoria e Infrastrukturas dhe Projekteve Publike// Sektori i Arsimit	0	7,000,000 6,000,000			13,000,000
2	Hapja e Procedurës së Prokurimit Publik	Sektori i Prokurimeve		0			
3	Supervizimi & kolaudimi	Operatori ekonomik/ Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit/ Drejtoria e Infrastrukturas dhe Projekteve Publike//					
				13,000,000			13,000,000
f) Periudha e zbatimit: 2024-2025				g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit			

Nr. 007	Projekti: Ndërtim terren sportive përpara kopshtit Abedin Dino	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Aktualisht mungon një terren sportive për shkollën dhe kopshtin që gjendet në të njëjtin territory. Bashkia Durrës ka menduar se me fondet e mbledhura nga taska e përkohshme që ka vendosur për arsimin parashkollor të ndërhyje duke ndertuar këtë terren në funksion të fëmijëve të kopshtit përgjatë vitit 2024 -2025.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
VKM nr. 159, datë 01.03.2017, “Për miratimin e standardeve të projektimit të kopshteve”, ka për qëllim që të shërbejë si referencë për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, programimit, projektimit/dizajnit dhe ndërtimit të ndërtesave/hapësirave të reja të kopshteve apo në rehabilitimin e ndërtesave ekzistuese. Në të paraqiten standardet për godinat e kopshteve në rast se duhet të ndërtohen të reja ose të rikonstruktohen.		
ii Synimi i projektit Ky projekt synon përmirësimin e infrastrukturës së jashtme të godinës së kopshtit bazuar në Standardet e VKM Nr. 159, duke i siguruar ambjente të përshtatshme dhe të sigurta për të zhvilluar lojëra të ndryshme për fëmijët.		
iii Niveli I ndërhyrjes A: Ligjore 1. Miratimi i buxhetit në KB.		
iv Aktivitetet kryesore të projektit 1. Miratimi i planit të përmirësimit dhe buxhetit në KB 2. Hapja e Procedurës së Prokurimit Publik 3. Supervizimi & kolaudimi		
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) 1. Kushte infrastrukturore të përshtatshme në kopshtin në përshtatje me VKM Nr. 159.		
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)	

<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; Sektori i Arsimit; 				<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Durrës 			
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)							
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026	Total
1	Miratimi i planit të përmirësimit dhe buxhetit në KB	Bashkia Durrës	0	10,000,000			10,000,000
2	Hapja e Procedurës së Prokurimit Publik	Sektori i Prokurimeve		0			
3	Supervizimi & kolaudimi	Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit/ Sektori i Arsimit					
				10,000,000			10,000,000
f) Periudha e zbatimit: 2024-2025				g) Ndjek zbatimin e projektit: Donatori bashkë me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit			

Nr. 008	Projekti: Shërbim mirëmbajta të godinave të kopshteve në territorin e Bashkisë Durrës.	Programi 09120 - përfshirë parashkollor	Buxhetor: Arsimi bazë arsimin
a) Përshkrim i shkurtër i projektit			

i Situata

1. Përgjatë vitit 2024 do të ofrohet shërbimi i mirëmbajtjes në vlerën prej 4,000,000 lekë për kopshtet:
 - 7 Marsi
 - Fotomonobeu
 - Parafabrikat
 - Kopshti në shkollën Bilal Golemi, kati i parë është kopshti me 110 femijë, me 4 grupe.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

VKM nr. 159, datë 01.03.2017, “Për miratimin e standardeve të projektimit të kopshteve”, ka për qëllim që të shërbejë si referencë për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, programimit, projektimit/dizajnit dhe ndërtimit të ndërtesave/hapësirave të reja të kopshteve apo në rehabilitimin e ndërtesave ekzistuese. Në të paraqiten standardet për godinat e kopshteve në rast se duhet të ndërtohen të reja ose të rikonstruktohen.

ii Synimi i projektit

Ky projekt synon përmirësimin e infrastrukturës së godinave të kopshteve bazuar në Standardet e VKM Nr. 159.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Miratimi i buxhetit për mirëmbajtje të kopshteve në KB.

B: Menaxheriale

1. Përgatitja e planit të përmirësimit të infrastrukturës/mirëmbajtjes/rinovimit apo meremetimit të kopshteve nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;
2. Hapja e Procedurës së Prokurimit Publik për gjetjen e operatorit ekonomik për ndërhyrjet në kopsht. Gjetja e operatorit dhe firmosja e kontratës;
3. Supervizimi i punimeve

C: Infrastrukurore

1. Përmirësimi i infrastrukturës/ meremetimi/ mirëmbajtja nga operatori ekonomik.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Miratimi i planit të përmirësimit dhe buxhetit në KB për kopshtet
2. Hapja e Procedurës së Prokurimit Publik
3. Supervizimi & kolaudimi

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Kushte infrastrukturore të përshtatshme për kopshtet e sipërpërmendura në përshtatje me VKM Nr. 159.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit;
- Sektori i Arsimit;
- Sektori i Prokurimeve.

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- Bashkia Durrës

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026	Total
1	Miratimi i planit të përmirësimit dhe buxhetit në KB.	Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit/ Sektori i Arsimit	0	4,000,000			4,000,000
2	Hapja e Procedurës së Prokurimit Publik	Sektori i Prokurimeve		0			
3	Supervizimi & kolaudimi	Operatori ekonomik/ Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit/ Sektori i Arsimit					
				4,000,000			4,000,000

f) Periudha e zbatimit:
2024-2025

g) Ndjek zbatimin e projektit:
Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit

3.5 Ushqimi

3.5.1 Planifikimi i shërbimit të ushqimit në kopshte

Informacion i përgjithshëm

Bashkia Durrës ka në administrim 56 kopshte me një numër prej 3350 fëmijë, nga këto:

- 11 kopshte me ushqim me 1379 fëmijë dhe
- 45 pa ushqim me 1971 fëmijë, të pozicionuara në 14 kopshte në qytet dhe 31 kopshte të atashuara pranë shkollave në Njësitë Administrative.

Kjo e dhënë nënkupton faktin se pjesa më e madhe e fëmijëve janë të regjistruar në kopshte me drekë, pavarësisht se numri i kopshteve me drekë është më i vogël se numri i kopshteve pa drekë. Siç e kemi evidentuar më sipër, kopshtet me drekë kanë më shumë fëmijë të regjistruar dhe janë më të kërkuara. Në disa zona kërkesa e prindërve për kopshtet me drekë është e lartë dhe planifikohet nga bashkia që numri i kopshteve me drekë të rritet. Në vitin 2024 numri i kopshteve me drekë do të jetë **14** duke lehtësuar shumë nënat të cilat do të mund të punojnë pasi sigurojnë fëmijët e tyre (aktualisht janë 11 kopshte nga të cilat 10 në qytetin e Durrësit dhe 1 në NJA Sukth të cilave i shtohen 3 kopshte të tjera, 2 në NJA. Manëz dhe 1 në Nishtulla Durrës që i takon komunitetit Rom dhe Egjiptian).

Shpërndarja e ushqimit kryhet çdo ditë nga furnitori në bashki dhe nga magazina e bashkisë pranë kopshteve. Komisioni i Vlerësimit është prezent çdo ditë për të vlerësuar produktet ushqimore të dërguara nga furnitori. Transporti kryhet nga shoferi me mjet frigoriferik. Ushqimi merret në dorëzim nga kuzhinierja e kopshtit. Në rast se kuzhinierja vë re se ushqimi nuk është i freskët njoftohet QEA e cila zëvendëson menjëherë ushqimin.

AKU kryhen kontrole të shpeshta, një herë në javë. Gjatë kontrollit kërkohet librezë shëndetsore e personelit.

Me VKB, kuota ushqimore është 50% për fëmijët binjakë. Në vitin 2020 është shtuar Paketa lehtësuese për pagesën e kuotës ushqimore 50% edhe për fëmijët në ndihmë ekonomike dhe fëmijët Rom dhe një sërë lehtësirash fiskale të cilat janë parashikuar në paketën fiskale dhe aplikohen në kopshtet e bashkisë Durrës.

Objektiva kryesore:

Mbulimi i kërkesës për shërbimin e ushqimit në kopshte

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Shtimi i 3 kopshteve me drekë në Njësitë Administrative të Bashkisë Durrës. Dy prej këtyre kopshteve janë në Njësinë Administrative Manëz dhe një në Nishtulla kopësht për komunitetin Rom e Egjiptian.

Lista e projekteve

Nr. 009	Projekti: Kthimi i 3 kopshteve me drekë dhe përlogaritja e kostove të ushqimit që nevojitet	Programi Buxhetor: 09120 -Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Bashkia Durrës ka në administrim 56 kopshte me një numër prej 3350 fëmijë, nga këto 11 kopshte me ushqim me 1379 fëmijë dhe 45 pa ushqim me 1971 fëmijë, 14 kopshte në qytet dhe 31 kopshte shkollash në Njësitë Administrative. Kjo e dhënë nënkupton faktin se pjesa më e madhe e fëmijëve janë të regjistruar në kopshte me drekë, pavarësisht se numri i kopshteve me drekë është më i vogël se numri i kopshteve pa drekë. Në disa zona kërkesa e prindërve për kopshtet me drekë është e lartë dhe planifikohet nga bashkia që numri i kopshteve me drekë të rritet.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Kërkesa e madhe për shërbimin e drekës bën që kopshtet që e ofrojnë këtë shërbim të jenë mbi kapacitetet. Për të tre kopshtet e planifikuara të kthehen në kopshte me drekë, përkatësisht "Koshti Sukth, Kopshti Kuçok dhe Isuf Ferra", rezultojnë të jenë në total 120 fëmijë, respektivisht, Kopshti Sukth 1 group me 20 fëmijë, kopshti Kuçok 2 grupe me nga 25 fëmijë, dhe Isuf Ferra dy grupe me nga 25 fëmijë. Për këtë arsye është e rëndësishme që, ashtu siç bashkia ka planifikuar, 3 kopshtet e mësipërme të kthehen në kopsht me drekë.		
ii Niveli i ndërhyrjes A: Ligjore 1. Miratimi në KB i planit dhe buxhetit për kthimin e kopshteve në kopsht me drekë. B: Menaxheriale 1. Planifikimi i punës dhe kostove për kthimin e kopshteve "Koshti Sukth, Kopshti Kuçok dhe Isuf Ferra" në kopshte me drekë, nga Sektori i Arsimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; 2. Hapja e procedurave të prokurimit publik dhe përzgjedhja e operatorëve ekonomik.		
iv Aktivitetet kryesore të projektit 1. Planifikimi i punës dhe kostot 2. Miratimi i planit në KB 3. Hapja e procedurave të prokurimit publik dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik		

4. Kthimi i kopshteve në kopshte me drekë.

Për kthimin e 3 kopshteve në kopshte me drekë nevojiten 11 punonjës dhe pagat për këto punonjës shtesë janë të parashikuara në buxhetin e bashkisë Durrës sikundër e theksuam dhe më sipër kur përmendëm numrin total të punonjësve(14 punonjës në total) të cilët do ti shtohen flotës aktuale të punonjëve që shërbejnë në kopshtet e bashkisë Durrës.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Mbulimi i kërkesës për kopshtet me drekë;

<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sektori i Arsimit • QEA • Sektori i Prokurimeve 	<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Operatori ekonomik
--	---

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Akt ual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Planifikimi i punës dhe kostot	Qendra Ekonomike e Arsimit	0	5,385,600			5,385,600
2	Miratimi i buxhetit për ushqimin në KB	QEA dhe Drejtoria e Buxhetit	0				0
3	Hapja e procedurave të prokurimit publik dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik	Sektori i Prokurimeve	0	0			0
4	Kthimi i 3 kopshteve	Operatori ekonomik					

	me drekë (ushqimi)						
			0	5,385,600			5,385,600
f) Periudha e zbatimit: 2024				g) Ndjek zbatimin e projektit: QEA			

4. Buxheti

Kategori a	Procesi	Projekti	Fakt Aktu al	Buxhet Vit 2024	Buxhe t Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periudhe
Proceset Mbështet ëse	Planifikimi i shërbimit të ushqimit në kopshte	Kthimi i 3 kopshteve me drekë dhe përlllogaritja e kostove të ushqimit që nevojitet		5,385,600			5,385,600
Proceset Mbështet ëse	Mirembajtj a e objekteve	Shërbim mirëmbajte të godinave të kopshteve në territorin e Bashkisë Durrës.		4,000,000			4,000,000
Proceset Mbështet ëse	Rikonstruk sion i objekteve	Ndërtim terren sportive përpara kopshtit Abedin Dino		10,000,000			10,000,000
Proceset Mbështet ëse	Rikonstruk sion i objekteve	Rikonstruks ion i Shkollës 9 vjecare Demokracia ku ka		13,000,000			13,000,000

Kategoria	Procesi	Projekti	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periudhe
		kopësht me dy grupe dhe kopshti Shkallë në Njësinë Administrative Manëz					
Proceset Mbështetëse	Burimet Njerëzore	Punësimi 14 punonjës në arsimin parashkollor – 7 punonjës edukativ dhe 7 punonjës shërbimi për arsimin parashkollor	14	12,215,000			12,215,000
Procesi i Menaxhimit	Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	Ngritja e Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	0	0	0	0	0
Procesi i Menaxhimit	Bordi i Kopshtit	Krijimi i Bordit të Kopshtit sipas Udhëzimit nr. 25	0	0	0	0	0
Procesi i Menaxhimit	Regjistrimi i fëmijëve në kopsht	Vlerësimi i Brendshëm i kopshteve	0	0	0	0	0
Procesi i Menaxhimit	Regjistrimi i fëmijëve në kopsht	Organizimi i aktiviteteve të përbashkta	0	0	0	0	0

Kategoria	Procesi	Projekti	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periudhe
		mes komunitetit dhe kopshteve					
Total			14	44,600,600			44,600,600